



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2105/6 prot.

Datë 12.09.2023

**V E N D I M**

**Nr. 883/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.09.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-75335-07-17-2023 me objekt *“Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit”* me fond limit 8,006,130.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09- 08-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A.

Skualifikimin e operatorit ekonomik B.O.E. PRIMUS ALBANIA Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k. në procedurën e mësipërme e prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK NIPT L12121023B dhe adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Dibër SH.A Lagjia Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë.

**Subjekt i interesuar:** BOE PRIMUS ALBANIA Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k NIPT L42202028V dhe Adrese: Tirane Rruga Margarita Tutulani, pallati Viridario 1

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18-07-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-75335-07-17-2023 me objekt “Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit” me fond limit 8,006,130.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09- 08-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër S.H.A.

II.2. Në datën 09- 08-2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 17.08.2023 ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Kreatx” SHPK	3652790	lekë	skualifikuar
“Primus Albania” SHPK	6910000	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 21.08.2023 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Njoftimi i Fituesit”, prej së cilit rezulton fitues operatori ekonomik “B.O.E. “PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k. me përfaqësues të këtij bashkimi O.E. “PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. ” SHPK.

II.5. Në datën 26.08.2023 , nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3381 dhe me nr. 2105/2023 prot., datë 28.08.2023 e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k. me përfaqësues të këtij bashkimi O.E. “PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. “ në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5.1 Në ankesë ngrihen pretendime nga ankimuesi për skualifikimin e tij dhe për mospërbushje nga ana e BOE PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k. me përfaqësues të këtij bashkimi O.E. “PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. të kriterëve si më poshtë vijon:

*Arsyet e skualifikimit: Në Dokumentat e Tenderit (D.T.), tek Njoftimi i Kontratës, pika 3.1.3. (faqja 7) është përcaktuar që pagesa e Sigurimit të Ofertës të kryhet në formën e garancisë bankare, ndërkohë që O.E. KREATX e ka kryer pranë një shoqërie sigurimi dhe jo në një banke.*

*Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK pretendon se operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK pjesëmarrës në këtë procedurë nuk I plotëson. Si më poshtë vijon: Ne shtojcën 8 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT Kriteri 2.3.3 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Prodhuesit për sistemin e faturimit të ofruar ose Autorizimin e Prodhuesit apo të distributorit të autorizuar për implementim e sistemit të faturim arkëtimit. Në Autorizim duhet të shënohen të dhënat e plota të kontaktit të prodhuesit.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. prot r. 2105/ 2 date 29.08.2023 , u

publikuan arsyet e skualifikimit dhe kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK pretendon, se nuk plotësohen nga operatori ekonomik PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k. me përfaqësues të këtij bashkimi O.E. “PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k.

II.7 Me shkresën nr. 916/1 prot., datë 31.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 2105/3 prot., datë 31.08.2023 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK, në të cilin konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar BOE PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k. me përfaqësues të këtij bashkimi O.E. “PRIMUS ALBANIA” Sh.p.k., ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore me nr prot 2105/4 datë 01.09.2023.

II.9 Me shkresën nr. 916/2 prot., datë 31.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 2105/5 prot., datë 04.09.2023 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni me lende “dergohet vendimi i Titullarit të Autoritetit Kontraktor”

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e ankimuesit “Kreatx” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor, gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.2. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se një prej

kritereve është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht:

III.2.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK se “Arsyet e skualifikimit: Në Dokumentat e Tenderit (D.T.), tek Njoftimi i Kontratës, pika 3.1.3. (faqja 7) është përcaktuar që pagesa e Sigurimit të Ofertës të kryhet në formën e garancisë bankare, ndërkohë që O.E. KREATX e ka kryer pranë një shoqërie sigurimi dhe jo në një bankë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.2. Në dokumentet standarde të tenderit, në seksionin **3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike** autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e sigurimit të ofertës është **160.123** (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e tre) **Lekë**.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 \_\_\_\_\_ (shuma, monedha)

Loti 2 \_\_\_\_\_ (shuma monedha)

**3.1.2** Autoriteti/ Enti ontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor

Nr.	Banka	Nr. Llogarisë
1.	<b>Dega e Bankës Credins në Peshkopi U.K. Dibër Sh.a., në numrin e llogarisë në lekë:</b>	<b>00001807329</b>

**3.1.3** Autoriteti/Enti Kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (shprehur në ditë)**

**Seksioni 4: Procedura**

**III.2.3** Në dokumentet standarde të tenderit, në seksionin **Seksioni I: Udhëzime për Operatorët EkonomikëA. TË PËRGGJITHSHME** autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Pika 9 1. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:

- a) *Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit kontraktor*
- b) *Garanci bankare*
- c) *Garanci sigurimi*

*Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.*

3. *Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor e refuzon Ofertën. Nëse autoriteti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.*

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. *Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. *Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.6 Në nenin 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Neni 83

### **Sigurimi i ofertës**

*1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:*

*i. në formën e garancisë bankare; ose*

*ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.*

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të:

a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;

b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit e ofertës, nëse:

a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës;

b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit;

c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës.

Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kerkesave/ kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kerkesave është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Referuar kerkesës së .I.2 Autoriteti/ Enti ontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor

Nr.	Banka	Nr. Llogarisë
1.	<b>Dega e Bankës Credins në Peshkopi</b> <b>U.K. Dibër Sh.a., në numrin e llogarisë në lekë:</b>	<b>00001807329</b>



### *3.1.3 Autoriteti/Enti Kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:*

*i. garancisë bankare X ose*

*ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente, Komisioni gjykon, se kjo kërkesë është kontradiktore, dhe jo ne përputhje me ligjin.*

Referuar frymes se legjislacionit, Autoriteti Kontraktor në hartimin e kësaj kerkese ku percakton se dokumenacioni i cili duhet dorëzuar për të plotësuar kërkesën e autoriteti kontraktor në lidhje me sigurimin e ofertës duhet bërë vetëm me Garanci Bankare është në kundërshtim me ligjin pasi në asnjë moment Ligji 162/2020 për prokurimin publik nuk parashikon vetëm një mënyrë në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit provues në lidhje me kërkesën për pagesën e Sigurimit të Ofertes pasi në nenin 83 të Ligjit Prokurimti Publik nr 162/2020 qartë mënyrat e pagesës së Sigurimit të Ofertes, dhe se cilat janë dokumentacionet të cilat përmbushen me këtë të fundit. Me vendosjen e kësaj kerkese Autoriteti Kontraktor kofuzion pjesëmarrjen e operatoreve ekonomik.

Referuar sa më sipër ky kriter krijon konfuzion dhe paqartësi.

Autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter në kundërshtim me ligjin 162/2020 të Prokurimit Publik ku janë përcaktuar qartë format e paraqitjes së sigurimit të ofertës të cilat mund të jenë në formën e garancisë bankare; ose nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente për operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Autoriteti është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

III.2.8 KPP gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar këto kërkesë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Kështu që, në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimuesit nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e ankesës, duke qenë se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.2.9. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të

*drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa mbi menyren e pageses (me garanci Bankare) se Sigurimit te Ofertes të vendosur nga autoritetit kontraktor në DST, është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.*

Sa më lart, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.3 Lidhur me evidentimin e kryer nga ana jone te autoritetit kontraktor në procedurën e prokurimit te sipercituar, ku autoriteti kontraktor ka kryer shkelje të ligjit dhe rregullave të prokurimit, si dhe parimeve kryesore mbi bazën e të cilave është hartuar ligji për prokurimin publik, referuar çështjes së mësipërme, KPP gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik, për nisjen e hetimit administrativ kundrejt Autoritetit Kontraktor, bazuar në nenin 23, të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-75335-07-17-2023 me

objekt “*Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit*” me fond limit 8,006,130.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-08-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim.
  4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**